REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
Notere-SHPRESA GJOCI
NIPT-NR.61621011S
Tel-0682071706

TAKSA U PAGUA
NR 2137 REP
NR 1641 KOL

**KONTRATE SHITJE**
**Kuotat e kapitalit themeltar te shoqerise" GAD Service "SH.P.K.**

Sot me datën 15.03.2018( dy mije e tetëmbëdhjete), dite e Enjte , ora 11.00, une notere Shpresa M GJOCI, me seli ne rrugen S.Delvina-TIRANE, vërtetoj se u paraqiten para meje personalisht.

**PALA SHITESE :**
-Alessandro Curigliano, i datëlindjes 26.05.1973, lindur ne Catanzaro , madhor, me zotësi te plote juridike për te vepruar, pajisur me karte identiteti për identifikim nr. AU 4202916, ne mungese, i përfaqësuar me prokure te përgjithshme nr. 1520 rep, nr. 1157 kol, date 21.02.2018 nga znj.Enejda Gjoci, e datëlindjes 20.12.1986, lindur ne Kavaje, banuese ne Tirane, madhore, me zotësi te plote juridike per te vepruar, pajisur me ID për identifikim, me nr. Personal I66220091T.

**PALA BLERESE :**
-IACOPO RAUCCI, i datëlindjes 11.08.1991, shtetas Italian, banues ne Itali, madhor, me zotësi te plote juridike për te vepruar, pajisur me karte identiteti për identifikim nr.AT 9087993, lëshuar nga Komuna Rome-Itali, kupton dhe flet gjuhen shqipe.

**BAZA LIGJORE:** Ligji "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare" dhe Ligji "Për Qendrën Kombëtare te Regjistrimit te biznesit ".

Palët e mësipërme kërkuan nga unë noterja përpilimin e ketij akti shitblerje te kuotave te kapitalit te shoqërisë " GAD Service "SH.P.K.si me poshtë vijon.

Shitësi është aksionari dhe pronar i vetëm i shoqërisë " GAD Service "SH.P.K dhe zotëron 100% kuotat e kapitalit te kësaj shoqërie , me numer nipti biznesi L 81420009V, me adrese ne

njësinë Bashkiake nr.5, rruga Nikolla Tupe, kulla 8- kateshe, kati 2, ndërtesa 13, nr.A1 - Tirane.

Shitësi, deklaron se kuotat e kapitalit te kësaj shoqërie, me te gjitha te drejtat dhe detyrimet ligjore e financiare, edhe ato te prapambeturat, ne masën 100% ja shet blerësit , konkretisht zotit. IACOPO RAUCCI, ne shumen40.000,00( dyzet e mije) leke.

Palët deklarojnë se janë likuiduar totalisht ne mes tyre, jashtë kësaj zyre noteriale dhe se nuk kane asnjë lloj detyrimi financiar ne mes tyre as tani dhe as ne te ardhmen.

Pala shitëse e garanton palën blerëse se kuotat e kapitalit te kësaj shoqërie nuk janë lenë peng , pra, nuk kane asnjë lloj barre hipotekimi dhe detyrimi apo marrëdhënie ndërvarësie me te tretet.

Me ketë veprim te bere ne mes palëve, behet pronar dhe aksionar i vetëm i shoqërisë - GAD Service - SH.P.K, ne masën 100%, vetëm zoti. IACOPO RAUCCI, , dhe i lind e drejta ligjore këtij te fundit qe te kryej ndryshimet përkatëse ligjore ne Q.K.B

Pala blerëse deklaron se sa me sipër është dakord.

Sa me sipër, u lexua, u gjend konform vullnetit te lire te palëve te mësipërm, u nënshkrua prej tyre dhe ne baze te ligjit u ligjërua nga unë notere.

PALA SHITESE
-Alessandro Curigliano

I perfaqesuar nga:

Enejda Gjoci

PALA BLERESE

Iacopo Raucci

E KUPTOVA

NOTERE
Shpresa M GJOCI

PULLE TARIFE
200 LEKE
R. SHQIPERISE

TAKSA U PAGUA

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
*Notere*-Shpresa M GJOCI
*NIPT* NR-K61621011S
*Tel*-0682071706

NR 1520 REP
NR 1157 KOL

## PROKURE E PERGJITHSHME

Sot me daten 21 . 02.2018 -(DY MIJE E TETEMBEDHJETE)-, une notere SHPRESA M GJOCI, me qender ne TIRANE, Njesia Bashkiake Nr.5, Rruga Sulejman Delvina, Godina Nr. 5/3, Hyrja nr.1, Ap nr.1 ,vertetoj se u paraqit para meje personalisht:

**I PERFAQESUARI-**SHOQERIA "GAD SERVICE" shpk, me seli ne Tirane, pajisur me numer NIPTI:L81420009V, perfaqesuar nga Zoti.ALESSANDRO CURIGLIANO, i datelindjes 26.05.1973, lindur ne Catanzaro, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, kupton dhe flet gjuhen shqipe, pajisur me leternjoftim Italian numer :AU 4202916.

BAZA LIGJORE-Neni 70-72 I k.Civil,neni 96 e ne vijim I K.Pr. Civile dhe neni 39 te ligjit 7829 date 01.06.1994.Per noterine:Ndryshuar me ligjin numer 9216 date 01.04.2004.

*Kerkoi nga une notere perpilimin e ketij akti perfaqesimi si me poshte vijon:*

Une, Zoti. ALESSANDRO CURIGLIANO, ne cilesine e perfaqesuesit ligjor te shoqerise "GAD SERVISE" shpk, me numer Nipti: L81420009V, deklaroj se:

**AUTORIZOJ:**

Znjsh. ENEJDA GJOCI, e datelindjes 20.12.1986, lindur ne Kavaje-Durres , pajisur me leternjoftim numer:I66220091T, qe te me perfaqesoje si me poshte vijon:

-I jap te drejta te plota perfaqesueses time per kryerjen e çdo veprimi ne lidhje me shoqerine "GAD SERVISE" shpk, me numer Nipti: L81420009V, duke e perfaqesuar shoqerine ne te gjitha zyrat e administrates Shteterore,ne nivel qendror e lokal, pa kufizim (Ne polici, prokurori, gjykate, zyren e gjendjes civile, dogane, Q.K.B, ZRPP, ALUIZNI, Tatim –Taksa, Bashki, Komuna te ndryshme, Ministri te ndryshme, Ambasada, Konsullata, ne D.R Sherb.Transport rrugor, Institucioni i Sigurimeve Shoqerore,…etj, per te dorezuar dhe terhequr dokumentacione, per te kryer praktika te ndryshme, duke ndermarre çdo veprim qe konsiston ne perfaqesimin me te drejta e kompetenca te plota ne administrimin dhe mbrojtjen e interesave te te shoqerise, duke patur te drejte perfaqesuesja ime qe te nenshkruaje ne emer dhe per llogari te shoqerise "GAD SERVISE" shpk, me numer Nipti: L81420009V.

ALESSANDRO CURIGLIANO

EKUPTOVA

...e te gjitha Bankat e Republikes se Shqiperise, te çdo lloj niveli, ku perfaqesuesja ime ...e kete te administroje te gjitha llogarite bankare te tashme dhe te ardhshme te shoqerise "GAD SERVISE" shpk, me numer Nipti: L81420009V, te kete te drejte te kryej veprime te ndryshme bankare pa kufizim, si dhe te beje transferta ose pagesa te ndryshme, paga te punonjesve, te terheqi dhe te depozitoje çfaredolloj sasie lekesh ose valute te huaj ne emer dhe per llogari te shoqerise.

-Te ndermarre çdo veprim qe konsiston ne pjesemarrjen e shoqerise ne tendera, te kerkoje e te nenshkruaje akte te bashkimit te perkohshem te shoqerive, prokura, te ndjeke proçedurat perkatese te tenderit duke nenshkruar per kete çdo document apo akt ligjor qe do te kerkohet.

-Te nenshkruaje kontrata e akte te tjera ligjore qe konsistojne ne administrimin e shoqerise, te ndermarre veprime per mbarevajtjen e puneve te shoqerise ne Shqiperi, te nenshkruaje me te tretet, persona juridike publike ose private, me institucionet perkatese apo ministrite, akte te ndryshme ligjore ne interes te shoqerise , si kontrate shitje dhe blerje, pasuri e luajtshme, dhe pasuri e paluajtshme, kontrata koncensioni, kontrata qeraje, sipermarrje, marreveshje, kontrate pune, porosie, ndermjetesimi, etj,. si dhe çdo akt tjeter ligjor qe do ta konsideroje te nevojshem e qe ka te beje me mireadministrimin e veprimtarise ekonomike te shoqerise.

-Te aplikoje dhe te nenshkruaje ne emer dhe per llogari te shoqerise kontrata kredie, huaje, si dhe çdo kontrate apo marreveshje, te tashme apo te ardhshme, qe konsiston ne kreditimin e shoqerise per ushtrimin e aktivitetit te saj ekonomik nga banka apo institucione financiare vendase apo te huaja, te nenshkruaje kontrata hipotekimi apo kontrata e marreveshje te tjera te ngjashme qe kane per objekt vendosjen e pasurive te shoqerise, te luajtshme apo te paluajtshme, si barre apo garanci per te garantuar Shumen e kredise/ huase, me te drejten per te administruar me te drejta e kompetenca te plota Shumen perkatese te kredise/ huase.

Perfaqesuesja ka te drejte te caktoje perfaqesues te tjere ne permbushjen e detyrave te sipercituara.

Te marre posten drejtuar shoqerise, si nepermjet sherbimit postar publik dhe privat.

Te kryeje çdo veprim tjeter qe nuk eshte shprehur ne prokure por qe I sherben realizimit te qellimit te kesaj prokure.

Sa me siper, u lexua, u gjend, konform vullnetit te lire te perfaqesuarit, u nenshkrua prej tij dhe ne baze te neneve te K.Civil, une notere e ligjeroj si me poshte vijon:

| I PERFAQESUARI<br>SHOQERIA "GAD SERVICE" shpk | NOTERE<br>Shpresa M GJOCI |
|---|---|
| ALESSANDRO CURIGLIANO<br>EKUPTOVA | GAD Service Sh.p.k.<br>NUIS : L 81420009 V<br>Tiranë - Albania |

**VENDIM NR. 1 DATE 15.03.2018**

**I ORTAKUT TE VETEM TE SHOQERISE " GAD Service "SH.P.K.**

Sot me datën 15.03.2018( dy mije e tetëmbëdhjete), dite e Enjte , ora 11.00, une ortaku i vetem i shoqerise:

-Alessandro Curigliano, i datëlindjes 26.05.1973, lindur ne Catanzaro , madhor, me zotësi te plote juridike për te vepruar, pajisur me karte identiteti për identifikim nr. AU 4202916, ne mungese, i përfaqësuar me prokure te përgjithshme nr. 1520 rep, nr. 1157 kol, date 21.02.2018 nga znj.Enejda Gjoci, e datëlindjes 20.12.1986, lindur ne Kavaje, banuese ne Tirane, madhore, me zotësi te plote juridike për te vepruar, pajisur me ID për identifikim, me nr. Personal I66220091T.

**Pasi u analizua qëllimi i ketij vendimi**

**V E N D O S A**

Te shes kuotat e kapitalit te shoqerise GAD Service "SH.P.K., me numer nipti biznesi L 81420009V, me adrese ne njësinë Bashkiake nr.5, rruga Nikolla Tupe, kulla 8- kateshe, kati 2, ndërtesa 13, nr.A1 - Tirane. ne masen 100%, zotit. IACOPO RAUCCI, i datëlindjes 11.08.1991, shtetas Italian, banues ne Itali, madhor, me zotësi te plote juridike për te vepruar, pajisur me karte identiteti për identifikim nr.AT 9087993, ne shumen 40.000,009 dyzete mije) leke.

Largohet si Administrator i shoqerise zoti. Alessandro Curigliano, dhe emërohet zoti. IACOPO RAUCCI.

Ndryshime te tjera nuk ka.

-Alessandro Curigliano,

I perfaqesuar me prokure nga: I PRANISHEM

Enejda Gjoci :

Iacopo Raucci

E KUPTOVA

NOTERE

Shpresa M GJOCI